

Studimi në Zvicër

Studimi në Zvicër është një broshurë që jep udhëzime të mjaftueshme për të huajt që dëshirojnë të studiojnë në ndonjërin nga universitetet zvicerane. Në këtë broshurë kemi përmbledhur disa materiale bazë rreth kushteve të cilat duhet plotësuar për ta fituar të drejtën e studimit.

- **Broshura mbi studimet në Zvicër**
 - Hyrje
 - Pranimi
 - Kërkesat e gjuhës
 - Kërkesat universitare
 - Programet e shkencave të aplikuara
 - Studimet pasuniversitare
 - Pranimi i diplomave
 - Pagesat e shkollimit
 - Lista e universiteteve
- **Lejëqëndrimet dhe vizat**
 - Hyrje
 - Shtetasit e BE-së dhe EFTA-së
 - Shtetasit e vendeve të treta
- **Burimet e materialeve**

Broshura mbi studimet në Zvicër

Hyrje

Zvicra ka një numër të madhë të universiteteve, instituteve teknologjike dhe qendra tjera të të mësuarit që e vënë sistemin arsimor ndër vendet më të mira në botë.

Arsimi në përgjithësi është i lirë në krahasim me disa shtete që kanë nivel të lartë të edukimit bazuar në standartet që i ka Zvicra duke i marrur shkollat publike të cilat i mbështet shteti zviceran.

Zvicra ka 12 universitete publike duke përfshirë edhe dy institute federale të teknologjisë, të cilët e rendisin vetvetën ndër më të mirët në rang botëror për shkencë dhe inxhinieri.

Tetë universitete të shkencave të aplikuara dhe 15 universitete të arsimimit të mësuesve janë jashtë sistemit publik të arsimit.

Studentet zakonisht mësojnë në gjuhët vendase (gjermanisht, frëngjisht ose italisht), ndërsa gjuha angleze po bëhet gjithnjë e më shumë e zakonshme në programet universitare.

Për një listë të programeve të ofruara në anglisht, ju lutem vizitoni webfaqen www.crus.ch

Pranimi

Duke qenë i pranuar si një i huaj në sistemin zviceran të arsimit të lartë kërkohen vlerësime të larta, aftësi gjuhësore dhe, në disa raste, përvojë e punës.

Kërkesat e sakta varen nga çfarë lloji i shkollës dhe programit dëshiron të ndjek një student. Ndonjëherë studentëve mund t'u kërkohet që ti nënshtrohen një provimi pranues për t'u siguruar që ata janë të aftë për ngarkesë punës.

Kërkesat e gjuhës

Studentët e huaj që dëshirojnë të përfundojnë studimet universitare në Zvicër duhet të demonstrojnë aftësitë e tyre gjuhësore në shkollën ku ndjekin mësimin. Provimet e gjuhës zakonisht mbahen dy herë në vit pranë Qershor dhe Gusht /Shtator në Fribourg.

Për ata që kanë nevojë për të përmirësuar aftësitë e tyre gjuhësore, janë disa mundësi që ofrojnë disa institute të cilat janë me pagesë.

Kandidatët duhet të regjistrohen nëpërmjet universitetit që kanë në plan të marrin pjesë.

Rreth listës së universiteteve dhe informacione tjera të nevojshme në këtë drejtim mund ti gjeni tek webfaqet www.crus.ch dhe www.vkhs.ch

Kërkesat universitare

Një student duhet të ketë arritur diplomën e shkollës së mesme që lejon qasje të përgjithshme në universitetet në vendin nga vjen. Universitetet zvicerane mund të kërkojnë nga studentët e huaj që ti nënshtrohen provimi pranues për të demonstruar një mesatare minimale në testin e gjuhës apo për të treguar se janë pranuar në universitetet nga vendi që vijnë.

Për kërkesa tjera më të detajuara do gjeni informacionet tek universitetet përkatëse që dëshironi të vijoni studimet.

Programet e shkencave të aplikuara

Një kërkesë bazë për pranim është që studentët të tregojnë së paku një vit përvojë pune në fushën e studimit. Studentët mund të nënshtrohen një provimi pranues ndërsa për disa student që kanë një mesatare të lartë të notave nga vendi që vijnë nuk kanë nevojë të nënshtrohen provimit pranues.

Studimet pasuniversitare

Pranimi për një program master apo doktoraturë si student me një diplomë universitare nga një universitet i huaj (jo-zviceran) kërkon, të paktën, njohjen e diplomave të huaja. Kjo kryesisht mvaret nga universitetet zvicerane për të vendosur, kështu që ju lutemi kontaktoni direkt universitetin përkatës për më shumë informacione.

Pranimi i diplomave

Autoritetet zvicerane janë të alëdituara të njohin diploma nga shkolla të shumta në mbarë botën. Për informacione më të detajuara ju lutem vizitoni webfaqen www.crus.ch

Pagesat e shkollimit

Universitetet zvicerane gëzojnë një të drejtë të konsiderueshme nga taksat publike, duke i bërë tarifën financiare të arsyeshme në krahasim me ato të disa shteteve ku tarifën janë shumë të larta.

Taksat ndryshojnë në mes universiteteve dhe programeve, por shpesh ka pak ose aspak ndryshim në tarifën për studentët zviceran dhe studentët e huaj, përveç në universitetin e Luganos (USI), ku studentët e huaj paguajnë dyfish në krahasim me studentët zviceran.

Shpenzimet e jetesës zakonisht sillen prej (19 000 – 29 000 CHF – franka zvicerane) në vit që mvaret se ku gjendet lokacioni i universitetit dhe jeta private e studentëve. Rreth tarifave të shkollimit vizitoni webfaqen www.crus.ch e cila ju informon me detajisht.

Lista e universiteteve

Institutet Federale të Teknologjisë

- EPFL – Instituti Federal i Teknologjisë **Lausanne**
www.epfl.ch
- ETHZ - Instituti Federal i Teknologjisë **Zurich**
www.ethz.ch

Universitetet Publike

- Universiteti i Bazelit (Basel)
www.unibas.ch
- Universiteti i Bernit (Bern)
www.unibe.ch
- Universiteti i Friburgut (Fribourg)
www.unifr.ch
- Universiteti i Gjenevës (Geneve)
www.unige.ch
- Universiteti i Lozanës (Lausanne)
www.unil.ch
- Universiteti i Lucernit (Luzern)
www.unilu.ch
- Universiteti i Nojkatelit (Neuchatel)
www.unine.ch
- Universiteti i St. Gallenit (St. Gallen)
www.unisg.ch
- USI - Università della Svizzera italiana (Lugano)
www.usi.ch
- Universiteti i Cyrihut (Zürich)
www.uzh.ch

Institucionet e nivelit universitar

- The Graduate Institute (Geneve)
www.graduateinstitute.ch
- IDHEAP Swiss Graduate School of Public Administration
www.idheap.ch
- IUKB - Institut Universitaire Kurt Bösch
www.iukb.ch
- Distance Learning University Switzerland
www.fernuni.ch

Universitetet e shkencave të aplikuara

- University of Applied Sciences of Western Switzerland
www.hes-so.ch
- University of Applied Sciences and Arts of Zurich
www.zfh.ch
- Bern University of Applied Sciences www.bfh.ch
- Lucerne University of Applied Sciences and Arts www.hslu.ch
- University of Applied Sciences of Eastern Switzerland
www.fho.ch
- University of Applied Sciences of Southern Switzerland
www.supsi.ch
- Kalaidos University of Applied Sciences Switzerland
www.kalaidos-fh.ch

Universitetet e Arsimimit të Mësuesve

- PH Bern – Pädagogische Hochschule
www.phbern.ch
- HEP Bejune
www.hep-bejune.ch
- HEP Fribourg
www.hepfr.ch
- Pädagogische Hochschule Graubünden
www.phgr.ch
- FHNW - Die PH für den Bildungsraum Nordwestschweiz
www.fhnw.ch
- PHSG - Pädagogischen Hochschule des Kantons St.Gallen
www.phsg.ch
- Pädagogische Hochschule Schaffhausen
www.phsh.ch
- Pädagogische Hochschule Thurgau
www.phtg.ch
- SUPSI -Dipartimento formazione e apprendimento
www.supsi.ch
- HEP Vaud
www.hepl.ch
- HEP Valais
www.hepvs.ch
- PHZ – Zentralschweiz
www.phz.ch
- PH Zürich
www.phzh.ch
- HfH - Interkantonale Hochschule für Heilpädagogik
www.hfh.ch

Lejëqëndrimet dhe vizat

Hyrje

Studentët që dëshirojnë të studiojnë në Zvicër duhet të marrin lejet e duhura nga autoritetet zvicerane për të qëndruar në vend. Ja se si funksionon procesi.

Vizat studentore janë lëshuar sikurse lejëqëndrimi për punëtorët e huaj, por për studentet që vijn nga vendet e BE-së gëzojnë procedura më të lehta në krahasim me studentët që vij nga vendet e treta apo jashtë zonës së BE-së.

Shtetasit e BE-së dhe EFTA-së

Brenda 14 ditëve të mbërritjes në Zvicër studentët nga këto vende duhet të regjistrohen tek autoritetet lokale në qytetin ku ata do të jetojnë për të aplikuar për leje qëndrimi.

Aplikantët duhet të provojnë se kanë sigurim shëndetësor dhe fonde të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e jetesës. Ata duhet të provojnë se kanë ardhur në Zvicër për të studiuar me kohë të plotë dhe se ata janë regjistruar si duhet në një universitet ose një kolegji të njohur.

Leja e qëndrimit do të lëshohet për kohëzgjatjen e programit, dhe zgjat një vit ose më pak. Nëse studimet zgjasin për një periudhë prej disa vitesh, leja është e vlefshme për një vit dhe duhet të vazhdohet çdo vit deri në përfundim të studimeve.

Studentët mund të gjejnë punë dhe të punojnë, por për jo më shumë se 15 orë në javë. Përndryshe studentët konsiderohen të punësuar dhe duhet të aplikojnë për leje pune.

Bashkëshortet apo fëmijët e varur mund të bashkohen me studentin në Zvicër. Anëtarët e familjes mund të punojnë.

Shtetasit e vendeve të treta

Studentët që nuk vijn nga shtetet e BE-së/EFTA duhet të aplikojnë për një vizë në ambasadën ose konsullatën zvicerane në vendin e tyre. Edhe Kosova hyn në këto shtete.

Kërkesa duhet të përfshijë një certifikatë nga shkolla ose institucioni që do të ndiqen, dëshmi për pagesën e taksave shkollore dhe mjetet financiare të mbështetjes gjatë studimeve, një premtim me shkrim që studenti do të largohet nga Zvicra pas përfundimit të programit, si dhe një CV. Autoritetet zvicerane mund të organizojnë një test të gjuhës për të siguruar që studenti është në gjendje të ndjekë mësimet.

Kantonet janë përgjegjës për dhënien e lejeve. Për informata të hollësishme për procedurën e aplikimit (kume aplikimi, cilat formularë duhet mbushur, sa kohë duhet etj), ju lutem kontaktoni zyrën përkatëse kantonale.

Një listë të adresave mund të gjeni tek broshura “Hyrja në Zvicër” në seksionin Lejë.

Burimet e materialeve

Të gjitha këto burime janë të bazuara nga

EDK - Konferenca Federale e Ministrave të Kantonëve të Arsimit www.edk.ch

Serving Swiss Universities www.switch.ch

Konfederata e Rektorëve të Universiteteve Zvicerane www.crus.ch

Përshtati: Faton Krasniqi